

Blerim Carani ¹

FORMAT E PRESIONIT POLITIKO-EKONOMIK NË KOSOVË NGA ADMINISTRATA SHTETËRORE JUGOSLLAVE GJATË VITEVE 1945-1960

ABSTRACT

The people of Kosovo during the Second World War made a great contribution to the liberation of Kosovo, in the fight against fascist and Nazi occupiers. This contribution is documented by the military brigades created in Kosovo, the number of victims, wounded, damages and destruction in general. The Albanian people of Kosovo joined the other people of Yugoslavia, with the idea and promises from the senior communist leaders for self-determination and free declaration for the political future of Kosovo. Enticing promises after the end of the war turned into political violence, liquidations of Albanian nationalists, economic pressures and instigation of mass migrations of Albanians to Turkey. In this paper, referring to archival sources and relevant publications on this topic, will be treated analytically some characteristic forms and methods that were applied by the Serbian political nomenclature and Yugoslav state bodies on the Albanian population of Kosovo in the first post-war period.

Keyword: Colonisation, Seizure, Weapon action, Emigration.

ABSTRAKT

Populli i Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore ka dhënë një kontribut të madh për çlirimin e Kosovës, në luftën kundër okupuesve fashistë e nazistë. Këtë kontribut e dokumentojnë brigadat ushtarake të krijuara në Kosovë, numri i viktimave, i të plagosurve, dëmtimet e shkatërrimet në përgjithësi. Populli shqiptar i Kosovës iu bashkangjiti popujve të tjerë të Jugosllavisë, me idenë dhe premtimet nga krerët e lartë komunistë për vetëvendosje dhe deklaram të lirë për të ardhmen politike të Kosovës. Premtimet joshëse pas përfundimit të luftës u shndërruan në dhunë politike, likuidime të nacionalistëve shqiptarë, presione ekonomike dhe nxitje të shpërnguljeve masive të shqiptarëve për në Turqi. Në këtë punim, duke iu referuar burimeve arkivore dhe botimeve relevante mbi këtë temë, do të trajtohen në mënyrë analitike disa forma dhe metoda karakteristike të cilat u aplikuan nga nomenklatura politike serbe dhe organet shtetërore jugosllave mbi popullatën shqiptare të Kosovës në vitet e para të pasluftës.

Fjalët kyçe: Kolonizim, konfiskim, aksioni i armëve, shpërngulja.

Hyrje

Pas përfundimit të luftës dhe vendosjes së pushtetit komunist në Kosovë, udhëheqësia shtetërore jugosllave më 8 shkurt-5 korrik 1945 e vendosi administrimin ushtarak, një diktaturë e egër që e eliminoi pushtetin e këshillave antifashiste. Me pretekst të “goditjes se reaksionit”, u kryen masakra masive mbi popullsinë shqiptare.² Krahas zbatimit të shpërnguljes, ultranacionalisti serb Çubrilloviç rekomandonte që me shpejtësi të zhvillohej procesi i kolonizimit sistematik të elementit serb në Kosovë pas shpërngules së detyrueshme të shqiptarëve. Siç vënte në dukje Çubrilloviç, ky kolonizim duhej të kishte rëndësi të madhe sociale, ekonomike dhe politike për shtetin jugosllav, ndërkaq mjeti kryesor që do të përdorej

¹ PhD candidate at the University of Prishtina “Hasan Prishtina” blerimcarani1@gmail.com

² Ana Lalaj. *Kosova rruga e gjatë drejt vetëvendosjes, 1948-1981*, (Tiranë, Mësonjëtorja e parë, 2000), 31-32.

për realizimin e këtij projekti nacional do të ishte dhuna dhe terrori i hapur i reparteve ushtarake mbi popullatën shqiptare.¹

Gjykata ushtarake

Gjykata ushtarake në Kosovë ka dënuar shumë persona në emër të popullit, duke i akuzuar ballistët si “bashkëpunëtorë të armikut”, me pretekst se ishin kundër shtetit jugosllav. Ata u dënuan me heqje lirie, burgim, konfiskim të pasurisë etj.² Personat e akuzuar së pari ishin marrë në pyetje nga organet shtetërore të sigurimit, ku ishin detyruar të jepnin deklaratata nën kërcënim. Gjyqi ushtarak për secilin rast hapte procedura, krijonte lëndë të veçanta, me numër të vendimeve-aktgjykimeve nga Gjykata Supreme e Jugosllavisë, duke iu shqiptuar dënime. Anëtarët e gjyqit ishin të gjithë të nacionalitetit serb.³

Gjendjen e rëndonte edhe presioni politik dhe ekonomik i i regjimit ushtarak, i kryer ndaj prodhuesve, kryesisht shqiptarë. Ushtria me urgjencë i kërkonte Ministrisë së Tregtisë dhe Furnizimit që t’ia dorëzonte të gjitha sasitë e artikujve ushqimore ashtu siç ishte parashikuar. Ministria ishte e obliguar që t’u jepte urdhëresa komisioneve në kuadër të Këshillave Popullorë të Rretheve, që të bënin përpjekje maksimale për t’i siguruar sa më parë sasitë e caktuara për t’ia dorëzuar ushtrisë.⁴

¹ Zamir Shtylla. “Shpërngulja e shqiptarëve në Jugosllavi pas luftës së dytë botërore 1950-1966”, E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi, (Tiranë: Akademia e shkencave e RPS të Shqipërisë, 1990), 430.

² ASHAK, Fondi (më tej F.), Gjykata Ushtarake, Viti (me tej V.) 1945-1946, Kutia (më tej K.) 5, Ukshin Rexhep Rexhepi, Dosja (më tej D.) 300-46, u dënua me 20 vjet heqje lirie dhe me humbjen e disa të drejtave qytetare, përveç atyre familjare; Rexhep Jonuzi, u dënua me 20 vjet heqje lirie, me punë të detyrueshme, dhe për 10 vjet me humbje e të drejtave politike e qytetare përveç atyre prindërore; Tahir (Asllan) Zymeri, D. 301-46, me 3 vjet burg dhe 2 vjet heqje e të drejtave civile e politike e qytetare; Raif Selimi, u dënua me 10 vjet heqje lirie dhe humbje e të drejtave qytetare; Tahir Neziri, D. 306-46, u dënua me 1 vjet heqje lirie e me punë të detyrueshme. Ishin të akuzuar si bashkëpunëtor të Ballistëve, kundër popullit dhe shtetit.

³ ASHAK, F. Gjykata Ushtarake, V. 1945-1946, K. 5, D. 307-46, Gjyqi ushtarak i divizionit në Prishtin Nr. 307/45, i përbërë nga kryetari i këshillit Zhivko Damjanovski, zëvendës kryetar i gjyqit dhe porutnik i gjyqit togerit Jankoviç Mileto ndihmës i shefit financiar të sektorit të III të divizionit dhe Velimir Cimboleviqit në shërbim pranë divizionit të pavarur të divizionit të III në të cilën procesverbal e udheheqi (mbajti) sekretari i gjyqit Vllado Nikoliq, ndërsa aktakuzën publike e paraqiti togeri Mirko Shukoviq prokuror i divizionit të III, për vepër penale ndaj Riza Ahmetit, bujk nga Zhabari i Epërm, veper penale nga neni 3 pika 7, u dëua me 7 vjet me (heqje lirie me punë të dhunshme dhe 4 vite humbje e të drejtave politike dhe qytetare përveç atyre familjare, kundër popullit dhe shtetit.

⁴ ANKM, Fondi KPRR.3, v.1945 K. 6, Departamenti i Tregëtisë e Furnizimit, Nr.2293, Ky departament ka kërkuar nga Ministria e Tregtisë dhe Furnizimit të Serbisë, që artikujt e padërguar: sanë, kashtë dhe fasule etj, për nevojat e ushtrisë për tre muajt qershor-gusht (seksioni i këtij departamenti nr. 2293/45.) i cili thotë:Artikujt e padorëzuar për ushtri, të dorëzohen me urgjencë, Prizren.

Kolonizimi dhe konfiskimet

Pas aneksimit të Kosovës, politika agrare e qeverisë serbe zbatoi ndaj popullsisë shqiptare forma të ndryshme presionesh¹. Reforma agrare, kolonizimi i tokave dhe shpërngulja e popullsisë shqiptare ishin një e tërë dhe e pandarë.² Në Kosovë krahas konfiskimit të pasurisë së “bashkëpunëtorëve të okupatorit dhe tradhtarëve” të vendit (qershor 1945), zhvillohet edhe sekuestrimi i pasurive të emigrantëve politikë edhe i kapitalit të huaj (1945). Pastaj përfundoi nacionalizimi gradual i ndërmarrjeve në degë të ndryshme të ekonomisë, nacionalizimi i bankave dhe monopolizimi i tregëtisë (7 dhjetor 1946 – prill – 1948). Shteti ndërmjet reformës agrare dhe kolonizimit (ligji 23 gusht 1945) si edhe grumbullimit të detyrueshëm të “tepricave”, ndërhyri në pronësin e tokave dhe në të drejten e shitblerjes ose përdorimit të prodhimeve bujqësore-blegtorale.³

Sjellja në Kosovë e kolonistëve nga mbarë Jugosllavia dhe nga disa vende fqinje do të thoshte përzierje jo vetëm e njerëzve të nacionaliteteve të ndryshme dhe të nivelit të ndryshëm kulturor, por edhe të dokeve dhe zakoneve të ndryshme. Shumica e kolonistëve vinin nga viset pasive ku blegtoria ishte degë kryesore ekonomike.⁴

Një nga veprimet e para dhe më të mëdha të planit për ndryshimin e marrëdhënieve të pronësisë që ndërmori Qeveria e përkohshme e RPFJ-së, ishte zbatimi i reformës agrare dhe kolonizimit.⁵ Më 3 gusht 1945 u miratua ligji për rishikimin e lejeve për ndarjen e tokave për kolonët dhe palët e interesuara agrare në Maqedoni dhe në rajonin e Kosovës dhe Metohisë, me të cilin synohej të korrigjoheshin keqpërdorimet dhe padrejtësitë.⁶

Kthimi i një numri të madh të kolonëve në Kosovë kishte filluar përpara së të dilte ligji për rishikimin e reformës agrare.⁷ Procesi për rishikimin e reformës agrare u bë një nga rrugët për forcimin e pozitës ekonomike të kolonëve serbë e malazezë, nëpërmjet rritjes së sipërfaqes së tokës në pronësi të tyre.⁸ Vendosija e kolonistëve në

¹ Kryeziu, Veli. Ndryshimet politiko-shoqërore në Kosovë 1918-1941 sipas shtypit mbarëshqiptar: (monografi), Lena Graphic Design, Prishtinë: 2021, 26.

² Kristaq Prifti. *Gjenocidi dhe Komplotet Antishqiptare të Serbomëdhenjve*, (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2017), 175.

³ Marenglen Verli. *Ekonomia e Kosovës në vragonjtë e politikës jugosllave 1945-1990*, (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2000), 91-92.

⁴ Milovan Obradović. *Reforma Agrare dhe Kolonizimi në Kosovë (1918-1941)*, (Prishtinë: Instituti i Historisë, 2005), 267.

⁵ Виолета, АЧКОСКА, *Задолжителниот откуп во Македонија 1945 – 1953*, (Скопје, Институт за национална историја, 1995), 31.

⁶ АЧКОСКА, *Задолжителниот*, 27.

⁷ Lefter Nasi. *Ripushtimi i Kosovës, Shtator 1944-Korrik 1945*, (Tiranë: Instituti i Historisë, 1994), 194-195.

⁸ Nasi. *Ripushtimi i Kosovës...*, 197.

tokat e fshatarëve shqiptarë nga periudha e Mbretërisë Jugosllave krijoi probleme, shtesë ekonomike dhe mori përmasa edhe politike.¹

Vendosja e kolonistëve u bë në të gjithë Kosovën, si presion specifik. Atyre iu premtuan kushte të veçanta, siç ishte përzgjedhja e vendbanimeve, toka, prona, infrastruktura etj. Edhe në territorin e Mitrovicës janë vendosur një numër i madh kolonësh, nëpër fshatra të ndryshme si: Lisicë, Shipol, Vaganicë, Svinjar, Zhabar etj. Zbatimin e këtij procesi e kryen organet e ashtuquajtura agrare, me procedura specifike. Për t'i joshur dhe t'u ndier më të sigurt kolonët, ju lëshuan edhe vendime, perkatësisht fletë-poseduese që ta kishin me dokumente pronën e marrë mbi vete.²

Me anë të vendimeve të tilla, komisioni ua dha të drejtën kolonëve që me anë të gjyqit ta përvetësonin pasurinë. Këto vendime më vonë u zëvendësuan me vendime të përhershme të këtij këshilli dhe të komisionit agrar. Ndërsa pronarët e mëhershëm shqiptarë të pronave nuk kishin të drejtë kthimi të pasurisë, por vetëm të drejtë ankese në Komisionin Agrar të Ministrisë së Kolonizimit pranë Këshillit Popullor në Prizren, në afat prej 8 ditësh.³

Presion shtesë për fshatarët ishte edhe sigurimi i ushqimit për kolonë dhe familjet e tyre deri në momentin e punësimit përfundimtar të tyre. Këshillat Popullorë Vendorë merrnin përsipër furnizimin sa u përket artikujve në bazë të nevojave javore, duke u bazuar në numrin e anëtarëve të secilës familje.⁴

Pushteti i kohës dhe strukturat e tij nuk kishin konsideratë as ndaj atyre që i dhanë bijtë e tyre në luftën kundër okupatorit nazist, e as ndaj atyre që okupatori i kishte plaçkitur e grabitur gjatë luftës. Mjaftonte që në atë kohë Partia Komuniste e

¹ Fehmi Pushkollli. *Lëvizja revolucionare e sindikatave dhe lidhja e sindikatave të Kosovës 1919-1975*, (Prishtinë: Këshilli Krahinor i lidhjes së Sindikatave të Kosovës, Enti i historisë së Kosovës, 1977), 163.

² ANKM, Fondi KPRR.3, K.23 Komisioni agrar revizionues, Keshilli Popullor i Rrethit në Mitrovicë, Vendime për dhënjën e tokave kolonistëve të ardhur, në baze të Reformes Agrare të vitit 1937. prsh; Markoviq Vidosav nga Rudari, ka të drejtë të shpërngulet-Vendoset në pasurinë e fshatit Lisicë, dhe i ipet nga komisioni një sipërfaqe prej 5 ha e 35 ari, duke e arsyetuar se ishte utrinë. Gjorgjeviq Radosav, nga Rudari vendoset në territor të Lisicës, dhe i ipet sipërfaqe prej 3 ha e 72 ari. Në këtë fshat janë ardhur edhe shume familje qe u kanë ndarë tokë dhe lëshuar dhe vendime; Gjorgje Zdravkoviq, vendimi nr.125 i dt.25 janar 1946, i merr 2.30 ha, Bllagoje Miletiq, vendimi nr.117, 25 janar 1946, 1.80 ha, Vlladimir Ristiç, nr i vendimit 109, 25 janar 1946, 3.60 ha, Lazareviq Ognjan, nr i vendimit 100, 22 nëntor 1946, 1,00 ha dhe Gjorgjeviq Radosav me nr të vendimit 98, i dt. 17 nëntor 1945, i merr 3.72 ha.

³ ANKM, Fondi KPRR. 3, K. 23, Regjistra të Interesit Agrar, Komisioni Agrar Revizionues, nr.178, me 15 janar 1946, Kryetar Milije Kovaçeviq, Keshilli Popullor i Rrethit në Mitrovicë. Më gjerësisht po e paraqesim përmbajtjen e një vendimi të tillë; Këshilli Popullor i rrethit sipas vendimit të komisionit revizionues agrar për rreth të Mitrovicës në bazë të ligjit mbi revidimin e pasurisë të ardhurve të K.Metohisë-shpalljes se KP të Qarkut në Prizren, nr 279 të dt.23 maj 1945.

⁴ ANKM, Fondi KPRR. 3, K-12, Departamenti i Tregtisë dhe Furnizimit, Nr. 3425, 12 prill 1946, Mitrovicë.

Jugosllavisë t'i shpallte kulakë¹. Popullsia shqiptare konsiderohej si “element i pasigurt”.²

Drejtoria Shtetërore e të Mirave Popullore, duke u bazuar dhe në komisionin vlerësues të pasurisë, të gjithë personave që shpallehin si “bashkëpunëtorë dhe shërbëtorë të armikut-okupatorit”, ua konfiskonte pasurinë, e të tillë kishte shumë.³

Edhe në Shqipëri zbatohet kjo formë, përmes konfiskimit të pasurisë të të arratisurve politikë dhe kriminelëve të luftës, duke marrë vendimet përkatëse jo më vonë se deri më 12 dhjetor 1946.⁴ Ku kishte dyshime e raste rezistence nga bujqit kulakë, bëhej kontrolli në shtëpi, merreshin masa kundër atyre që përpiqeshin ta fshihnin prodhimin dhe demaskoheshin para popullit.⁵

Aksioni i armëve

Aksioni për mbledhjen e dhunshme të armëve në Kosovë i kryer gjatë viteve 1955-1956, u zbatua me metoda tejet represive, duke rezultuar me pasoja të rënda për popullin shqiptar në Kosovë e më gjerë. Ky aksion në fakt ishte kulmi i terrorit shtetëror, i cili u zbatua nga pushtetarë ultranacionalistë serbë dhe bashkëpunëtorë të caktuar shqiptarë.⁶

Zbatimi rigoroz i këtij aksioni i detyroi shumë kryefamiljarë shqiptarë që nuk posedonin armë, t'i blinin ato, madje nga vet pjesëtarët dhe bashkëpunëtorët e UDB-së, vetëm e vetëm që ta përmbyshnin detyrimin e dorëzimit të një apo më shumë armëve dhe për të shpëtuar nga represioni.⁷ Në këtë aksion antishqiptar, që zgjati 3-4 muaj, u keqtrajtuat në mënyrë brutale rreth 30 000 shqiptarë dhe vdiqën nga tortura çnjerëzore mbi 100 veta.⁸

Aksioni për grumbullimin e armëve, i cili u përgatit më herët dhe u krye në dimrin e vitit 1956, është iniciuar dhe përgatitur në qarqet e sigurimit shtetëror të nivelit krahinor, republikanë dhe me pëlqimin e autoriteteve të Federatës, sidomos Svetislav Stefanoviqit dhe Aleksandar Rankoviqit. Informatat për zhvillimin dhe

¹ Izber Hoti. *Orientime dhe qëndrime politike të shqiptarëve në Kosovë*, (Prishtinë: Faik Konica, 2010), 40.

² Jusuf Osmani. *Vendbanimet e Kosovës 17, Besiana (Podujeva)*, (Prishtinë: 2005), 65.

³ ASHK, Fondi-Këshilli Nacional Çlirimtar Krahinor, K-1 1945/46, Procesverbali i mbajtur i dt.22.02.1946, i komisionit vlerësues, Mitrovicë. Konfiskimi i pasurisë u bë në shumë komuna të Kosoves, ne po i paraqesim ca në komunën e mitrovicës: Mustafe Hamiti nga Mitrovica, ju ka marrë një ndërtesë në vlerë prej 100 mijë dinaresh, dhe një arë prapa shtëpisë. Poashtu vëllau të tij, Rizah Hamitit një arë prej 91 ari.Qazim (Ibrahim) Deva, iu kanë konfiskuar 3 shtëpi, nje arë prej 4 hektar e 99 m2.

⁴ AQSH, F. 491, K. 2, Ministria e Financave, Komisioni i Kontrollit të shtetit, Plan Pune, pika e katërtë e Procerverbalit Nr. 67/18-19, 1946, Korçë.

⁵ AQSH, F. 521, K. 19, Dok. 8, Republika Popullore e Shqipërisë-Ministria e Tregëtise, Njoftim Nr. 514/1459, nga Komitetet ekzekutive të N/Prefekturave, gjegjësisht Drejtoria Qëndrore për Grumbullim, dërguar Kryeministrit –Komisionit Kontrollit, Tiranë, më 19/12/1947.

⁶ Mehmet Gjoshaj. *Aksioni i Armëve ne Kosovë, me 1955-1956*, (Prishtinë, Muzeu i Kosovës, 2012), 7.

⁷ Gjoshaj. *Aksioni...*, 8.

⁸ Bep Jubani. et. al. *Historia e Shqipërisë dhe e shqiptarëve*, (Prizren: 2001), 362.

suksesin e aksionin u dërgoheshin drejtpërdrejt atyre në baza ditore. Qëllimi i aksionit ishte mbledhja e armëve që posedonte popullata, me pretekst se ishte armiqësore ndaj Jugosllavisë. Në fakt, prapavijë e këtij aksioni ishte synimi për të nxitur frikë dhe pakënaqësi në mesin e popullatës shqiptare duke llogaritur edhe në shpërnguljen sporadike të elementit shqiptar nga pronat e tyre.

Mënyra me të cilën është kryer veprimi i ka tejkaluar të gjitha të drejtave kushtetuese dhe ligjore. U aplikuan ngacmime, nga goditja me shuplakë deri te masat drastike të torturës dhe të likuidimit fizik. Nuk ishin të rralla rastet e arratisjes përtej kufirit për t'i shpëtuar torturave. Në bazë të raportimeve të familjarëve apo dëshmitarëve okularë, vetëm deri më 8 shtator 1945, 16 persona ishin vranë, 2 ishin vetëvranë dhe 11 kishin mbetur me lëndime të rënda fizike. Këto të dhëna bazohen vetëm në aplikimet e pranuar nga Komisioni.

Por, një numër i madh i qytetarëve të cilët janë rrahur dhe keqtrajtuar në mënyra të ndryshme nuk kishin bërë kallëzime. Në bazë të raportit që më pas iu dërgua organeve më të larta të Sektorit për Punë të Brendshme, rezulton se ishin grumbulluar 9.074 pushkë, 3.500 pistoleta, 109 automatikë, 67 mitralozë dhe disa qindra mijëra municione të ndryshme, funksionale dhe jofunksionale. Është karakteristike të theksohet se në atë kohë, blerja dhe shitja e armëve të ndryshme zhvillohej si në vetë Krahinën, ashtu edhe jashtë saj, pra, siç u cek më lartë, për të plotësuar kërkesat e autoriteteve të sigurimit shtetëror.¹

Këto masa të UDB-së ndikuan drejtpërdrejtë në qëndrimin negativ të popullatës shqiptare ndaj rendit shoqëror. Shkelja e rregullave kushtetuese dhe ligjore, keqtrajtimet dhe inskenimet e ndryshme ngjallën frikë te qytetarët, krijuan ndjenjën e mosbesimit dhe të pasigurisë, pakësuan pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në jetën shoqërore-politike të vendit. Mbi të gjitha, një numër qytetarësh pësuan dëme të konsiderueshme materiale dhe psikologjike të shkaktuara nga ngacmimet, vrasjet, arrestimet dhe vuajtja e dënimit pa faj të vërtetë. Në thelb, ishte një përqendrim i pakontrolluar i pushtetit në duart e individëve dhe të shërbimit në tërësi.²

Në Mitrovicë (në plenumin e datës 20.VIII) se gjatë aksionit për grumbullimin e armëve janë rrahur masivisht njerëzit, janë vranë disa qytetarë të ndershëm që nuk kishin armë.³

Metodat e mëtejshme ishin futja e materialeve komprometuese te persona të caktuar, në mënyrë që të përdorej si korpus delikti gjatë arrestimit të tyre. Po ashtu në Mitrovicë, një bashkëpunëtori të UDB-së i është dhënë një Schmeizer, një pushkë dhe disa flamuj shqiptarë, për t'ia dhënë një personi të caktuar shqiptar, por që më pas,

¹ ASHAK, Fond i Sekretariatit, K. 15, D. 18-19, fl. 6.

² ASHAK, Fond i Sekretariatit, K. 15, 7.

³ ASHAK, Fond i Sekretariatit K. 15, 86.

operativi e ka kapur personin në fjalë me atë material komprometues dhe e ka dorëzuar në gjykatë për ndjekje penale.¹

Shpërngulja

Të gjitha format e presionit nga shteti i Jugosllavisë pas Luftës së Dytë Botërore në esencë kishin qëllimin që ta ndryshonin strukturën e popullsisë në Kosovë,² duke e nxitur shpërnguljen e tyre nga Kosova. Situata e krijuar nga përplasja mes PKJ-së dhe PKSH-së reflektoi në të gjithë jetën politike dhe ekonomike të RPFJ-së.³

Pas prishjes së marrëdhënieve me Shqipërinë dhe izolimit të plotë të Kosovës nga Shqipëria, udheheqësit jugosllavë i kishin duart e lira për t'i vënë në jetë projektet antishqiptare ende të parealizuara nga koha e Mbretërisë Jugosllave.⁴

Skenaristët e marrëveshjeve dhe projekteve të shpërnguljeve i fshihnin dosjet, ndërsa shkenca jugosllave ishte në shërbim të fshehjes dhe heshtjes së ekzodit shqiptar. Turqia ishte vendi më imigrues për shqiptarët nga të gjitha trojet e tyre. Vlerësohet se vetëm në periudhën 1912-1967 janë dëbuar rreth 1,000.000 shqiptarë për në Azi, kryesisht në Turqi.⁵ Shpërngulja e shqiptarëve të Jugosllavi në vitet 1946-1966 u realizua sipas udhëzimeve të përcaktuara në referatin “Problemi i minoriteteve në Jugosllavine e re”.⁶

Politika serbomadhe e gjenocidit mori forma më të avancuara në Elaboratin e V. Çubrilloviçit. “Shqiptarët, shkruante ai, është e pamundur të sprapsen me anë të kolonizimit gradual... Meqë ngushtimi gradual i shqiptarëve me anë të kolonizimit të ngadalshëm është i paefektshëm, atëherë na mbetet e vetmja rrugë, shpërngulja në masë”. Lidhur me mjetet që rekomandonte të përdoshin për shpërnguljen e shqiptarëve, Çubrilloviq nënvizonte se “e vetmja mënyrë dhe i vetmi mjet për shpërnguljen e shqiptarëve është forca brutale e pushtetit shtetëror, shtrëngimi i tyre nga aparati shtetëror.” Shteti, sipas këtij elaborati, duhej të përdorte mjetet më barbare që nga burgosjet, gjobat, taksat, zbatimi i pamëshirshëm i të gjitha dispozitave ligjore, masat ekonomike si mosnjohje e tapive, marrja e kullotave shtetërore dhe komunale, mbyllja e dyqaneve, largimet nga puna etj. që do ta bënin të padurueshme qëndrimin e shqiptarëve në Kosovë e deri te masakrat masive.⁷

¹ ASHAK, Fond i Sekretariatit K. 15, 28.

² Arsim Sinani & Veli Kryeziu, *Yugoslav Totalitarian Society, Discrimination Against Albanian and Bulgarian Minorities in Macedonia*, Балканистичен Форум ,3, 32/2023, P. 167-185

³ V. АЧКОСКА, 3.0 во М..., 46.

⁴ Lalaj. *Kosova...*, 55.

⁵ Rifat Blaku. “Shkaqet e ekzodit shqiptar”, në *Shpërnguljet e shqiptarëve gjatë shekujve*, (Prishtinë: Shoqata për kthimin e shqiptarëve të shpërngulur nga Kosova, 1992), 202-204.

⁶ Pajazit Nushi. “Motive psikologjike të mërgimit të shqiptarëve në vitet 1945-1966”, në *Shpërnguljet e shqiptarëve gjatë shekujve*, (Prishtinë: Shoqata për kthimin e shqiptarëve të shpërngulur nga Kosova, 1992), 318.

⁷ Prifti. *Gjenocidi...*, 178-179.

Më 5 janar 1945, Vasa Qubrilloviq, me projektin e ri me titull “Pakicat në Jugosllavi”, program ky për likuidimin e shqiptarëve, hebrenjve, romëve, turqve, kroatëve, myslimanëve dhe gjermanëve.¹ Në funksion të këtij objektivi ishte edhe “marrëveshja xhentelme” e arritur midis Jugosllavise dhe Turqisë, në kuadër të nënshkrimit të Paktit Ballkanik, ndërmjet Jugosllavisë, Greqisë dhe Turqisë në vitin 1953.²

Hartuesit e projekteve antishqiptare nuk ishin njerëz të thjeshtë, por akademik serbë. Në zbatim të tyre ishte politika dhe organet e sigurimit shtetëror.

Masat represive gjatë grumbullimit të armëve, ndikuan drejtpërdrejtë në shpërnguljen e një numri të konsiderueshëm të qytetarëve shqiptarë. Por masat e organeve të sigurimit të shtetit, veçanërisht në vitin 1956, kontribuan në rritjen e numrit të arratisjeve apo emigrimeve.³

Konkluzion

Populli i Kosovës pas Luftës së Dytë Botërore përjetoj shumë presione të rënda nga organet e pushtetit të ish-RFPJ-së. Qëllimi i këtij kompleksi presionesh ishte të likuidohej popullsia shqiptare që nga politikanët serbë konsiderohej "element i huaj". Nga shtrirja, karakteri dhe rrënjët ideologjike të këtyre presioneve, pasojat e tyre të rënda janë të dukshme: Pasojat më të rënda janë ato që kanë ndikuar në marrëdhëniet ndëretnike. Presionet dhe veprimet e UDB-së kundër pjesëtarëve të nacionalitetit shqiptar rrënjosën në këtë pjesë të popullsisë besimin në pabarazinë e tyre me popujt e tjerë, përhapën atmosferën e shovinizmit tek popujt; ushqeheshin elementë reaksionarë dhe të tjerë armiqësorë.

Presionet e UDB-së ndikuan në krijimin e një qëndrimi negativ të popullatës ndaj rendit shoqëror. Shkelja e rregullave kushtetuese dhe ligjore, keqtrajtimet dhe inskenimet e ndryshme ngjallën frikë të qytetarët, krijuan ndjenjën e mosbesimit dhe pasigurisë, pakësuan pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në jetën shoqërore-politike të vendit; mbi të gjitha, një numër qytetarësh pësuan dëme të konsiderueshme materiale dhe psikologjike të shkaktuara nga ngacmimet, vrasjet, arrestimet dhe vuajtja e dënimit pa asnjë pikë faji.

A. Burime arkivore

(ASHAK) – Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës – Prishtinë:

Fondet:

Fond i Sekretariatit OK, PK, SK 1966-1967.

Fondi: Gjykata Ushtarake.

¹Hakif Bajrami. “Politika pansllaviste serbe në luftë për shfarosjen e shqiptarëve 1836-1999”, Vjetari Nr. 31, (Prishtinë: Agjencia shtetërore e arkivave të Kosovës, 2004,) 134. (Dokumenti është në Arkivin e Jugosllavisë edhe në AVIIB 1945).

² Lalaj. *Kosova...*, 105.

³ ASHAK, Fond i Sekretariatit, OK, PK, SK 1966-1967, K. 15, 7.

Fondi: 157, Këshilli Nacional Çlirimtar Krahinor, 1945/46,

(AQSH) – Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë Tiranë:

Fondet:

Fondi: 491, K-2, Ministria e Financave-Komisioni i Kontrollit të shtetit, Plan Pune, pika e katërtë e Procerverbalit nr.67/18-19, 1946, Korçë

Fondi: 521, K-19, dok-8, Republika Popullore e Shqipërisë-Minstria e Tregëtisë, Njofitim nr.514/1459.

(ANKM)-Arkivi ndërkomunal i Mitrovicës

Fondi: 3. KPRRZ – Këshilli Popullor i Rethit të Zveçanit

Spektori për Bujqësi.

Literatura

Bajrami. Hakif, "Politika pansllaviste serbe në luftë për shfarosjen e shqiptarëve 1836-1999", Vjetari Nr. 31, (Prishtinë: Agjencia shtetërore e arkivave të Kosovës, 2004), (Dokumenti është në Arkivin e Jugosllavisë edhe në AVIIB 1945).

Blaku. Rifat, "Shkaqet e ekzodit shqiptar", në Shpërnguljet e shqiptarëve gjatë shekujve, (Prishtinë: Shoqata për kthimin e shqiptarëve të shpërngulur nga Kosova, 1992).

Gjoshaj. Mehmet, Aksioni i armëve në Kosovë, me 1955-1956, (Prishtinë: Muzeu i Kosovës 2012).

Hoti. Izber, Orientime dhe qëndrime politike të shqiptarëve në Kosovë, (Prishtinë: Faik Konica, 2010).

Jubani. Bep, et. al. Historia e Shqipërisë dhe e shqiptarëve, (Prizren: 2001).

Jusuf. Osmani, Vendbanimet e Kosovës 17, Besiana (Podujeva), (Prishtinë: 2005).

Lalaj. Ana, Kosova Rruga e gjate drejt vetevendosjes 1948-1981, (Tiranë Mësonjëtorja e pare, 2000).

Kryeziu, Veli. Ndryshimet politiko-shoqërore në Kosovë 1918-1941 sipas shtypit mbarëshqiptar: (monografi), (Prishtinë: Lena Graphic Design, 2021).

Nasi. Lefter, Ripushtimi i Kosovës, Shtator 1944-Korrik 1945, (Tiranë: Instituti i Historisë, 1994).

Nushi. Pajazit, "Motive psikologjike të mërgimit të shqiptarëve në vitet 1945-1966", në Shpërnguljet e shqiptarëve gjatë shekujve, (Prishtinë: Shoqata për kthimin e shqiptarëve të shpërngulur nga Kosova, 1992).

Obradoviq. Milovan, Reforma Agrare dhe Kolonizimi në Kosovë (1918-1941), (Prishtinë: Instituti i Historisë, 2005).

Prifti. Kristaq, Gjencidi dhe Komplotet Antishqiptare të Serbomëdhenjve, (Tiranë: Akademia e shkencave e Shqipërisë, 2017).

Pushkollli. Fehmi, Lëvizja revolucionare e sindikatave dhe lidhja e sindikatave të Kosovës 1919-1975. (Këshilli Krahinor i lidhjes së Sindikatave të Kosovës, Enti i historisë së Kosovës, 1977).

Sejdiu. Fatmir, Politika Agrare si Instrument i Shtypjes Nacionale në Kosovë, (Prishtinë: 2001).

Arsim Sinani & Veli Kryeziu, Yugoslav Totalitarian Society, Discrimination Against Albanian and Bulgarian Minorities in Macedonia, Балканистичен Форум, 3, 32/2023, P. 167-185, <https://doi.org/10.37708/bf.swu.v32i3.9>

Shtylla. Zamir, "Shpërngulja e shqiptarëve në Jugosllavi pas luftës së dytë botërore 1950-1966", në E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi, (Tiranë, Akademia e shkencave e RPS të Shqipërisë, 1990).

Verli. Marenglen, Ekonomia e Kosovës në Vargonjtë e Politikës Jugosllave 1945-1990, (Tiranë: Mësonjëtorja e parë, 2000).

АЧКОСКА, Виолета Задолжителниот откуп во Македонија 1945 – 1953, (Скопје: Институт за национална историја, 1995).